

VENDIM
Nr. 250, datë 9.5.2018

**PËR NJË RISHPËRNDARJE TË FONDEVE TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE
RAJONALE NGA FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT NË DISA NJËSI TË QEVERISJES
QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet buxhetore, të miratuara në buxhetin e vitit 2018, për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në programin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, rishpërndahen në disa institucione qendrore, që janë autoritete kontraktuese, për financimin e projekteve në vazhdim të infrastrukturës vendore, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, Agjencia për Zhvillimin Rajonal 2 dhe Agjencia për Zhvillimin Rajonal 3 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela nr. 1. Rishpërndarja e fondeve buxhetore për projektet në vazhdim të FZHR-së, për njësitë qendrore

Entiteti i qeverisjes	Ministria e linjës	Kodi i institucionit	Autoriteti kontraktues	Kap.	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i D. së Thesarit	Kodi i projektit	Emri i projektit	Debiti
			PAKËSOHET							213.251.929
001	56	1056001	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	01	06220	2310000	3535	M560443	Infrastruktura vendore dhe rajonale	213.251.929
			SHTOHET							213.251.929
001	87	1087024	AZHR 3	01	01150	2310000	3535	M870208	Rigjallërimi i vlerave historike, kulturore e turistike të Zonës së Zhvillimit Rajonal 3, Korçë, Elbasan (3 lote)	83.325.107
001	87	1087021	AZHER	01	01150	2310000	3535	M870209	Qendër multifunkionale e shërbimeve për sipërmarrjet e reja	39.701.753
001	87	1087023	AZHR 2	01	01150	2310000	3535	M870207	Përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës ndërlidhëse Qafë-Shtamë (Bashkia Krujë) - Burrel (Bashkia Mat), me qëllim promovimin e atraksioneve turistike të Parkut Kombëtar të Qafë-Shtamës (loti 2.1). (infrastrukturë rrugore me interes të veçantë zhvillimi)	90.225.069